



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.276/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.276/2026, të datës, 12.03.2026, të parashtruar nga ankuesit A.G, A.M, F.S, S.S, Y.B, dhe B.G, me autorizues të përbashkët A.G nga Ferizaj, kundër organit të punësimit: Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.276/2025, e datës 12.03.2026, e parashtruar nga ankuesit A.G, A.M, F.S, S.S, Y.B, dhe B.G, në atë mënyre që e drejta e ankuesve për kompensimin e diferencës së pagës së ekspertit **aprovohet** nga hyrja në fuqi të Rregullores (QRK) NR.22/2024 të datës 27.08.2024 për Ekspert, ndërsa refuzohet pretendimi për realizimin e kompensimit nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit NR.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, që brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohet në pikën **I** të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

A.G, A.M, F.S, S.S, Y.B, dhe B.G (*tani e tutje referuar si ankuesit*), më datë 12.03.2026, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos kompensimit të diferencës së pagës sipas listës së ekspertëve në mënyrë retroaktive nga muaji shkurt 2023 deri në hyrjen në fuqi të vendimit Nr.08/280, lidhur me aprovimin e raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike për Ekspertët të paraparë me shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 18.03.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Zyra e Kryeministrit (*me tej ZKM*), ndërsa, kjo e fundit, me datë 19.03.2026, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me provat materiale lidhur me këtë çështje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1276/2026 të datës 12.03.2026 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim të datës 11.03.2026; Dokumentet e identifikimit të ankuesve; Emalin e datës 26.02.2026; Emalin e datës 10.03.2026; Emalin e datës 24.02.2026; Vendimin me NR.08/280 të datës 19.12.2025; Raportin e tretë të punës së Komisionit për Vlerësimin e sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rendësi Strategjike; Kërkesën me NR.518 të datës 24.03.2023; Kërkesën me numër 027 të datës 10.01.2025 të ankuesve drejtuar Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të informacionit dhe Komunikimit me rendësi Strategjike; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 19.03.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 19.03.2026; Akt emërimin me numër prtokolli:236/2024 të datës 08.07.2024 të ankuesit A.G; Akt emërimin ,me numër protokolli 163/2013 të datës 29.03.2013 të ankuesit A.G si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin me numër protokolli:242/2024 të datës 08.07.2024 të ankuesit S.S; Akt emërimin me numër protokolli:143/2014 të datës 25.02.2014 të ankuesit S.S si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin me numër protokolli; 241/2024 të datës 08.07.2014 të ankuesit F.S; Akt emërimin me numër protokolli 144/2014 të datës 25.02.2014 të ankuesit F.S si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin me numër protokolli 238/2024 të datës 08.07.2024 të ankuesit Y.B; Akt emërimin me numër protokolli 541/2013 të datës 01.08.2013 të ankuesit Y.B si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin me numër protokolli:248/2024 të datës 08.07.2024 të ankuesit A.M; Akt emërimin me numër prkotokolli:145/2014 të datës 25.02.2014 të ankuesit A.M si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Akt emërimin me numër protokolli:283/2024 të datës 08.07.2024 te ankuesit B.G; Akt emërimin me numër protokolli: 1073 të datës 29.11.2011 të ankuesit B.G si dhe përshkrimin e detyrave të punës; Shkresën e datës 06.01.2026 të ZKM drejtuar Thesarit lidhur me konfirmimin e mjeteve buxhetore për muajin janar 2026;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesve është e bazuar, ***sepse:***

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se të gjithë ankuesit kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil dhe janë të punësuar në kuadër të ZKM-së, tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton së Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin Nr.07/132 të datës 08.03.2023, ka themeluar Komisionin për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave të dërguara nga institucionet që kanë të bëjnë me sistemin shtetërore të informacionit dhe

komunikimit më rëndësi strategjike sipas Rregullores Nr.11/2023 për Ekspertët dhe dërgimin në Qeveri, të listës së Eksperteve, të kategorizuar në shtojcën 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Komisioni për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimet më Rëndësi Strategjike, ka përgatit Raportin e punës, listën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimeve me rëndësi strategjike dhe listën e pozitive të eksperteve sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, të cilat janë miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Zyra e Kryeministrit ka qenë pjesë e këtij procesi që nga fazat e para te tij, dhe ka paraqitur kërkesa të vazhdueshme për vlerësimin e sistemeve dhe të pozitive përkatëse, ku me datën 24.03.2023, është paraqitur kërkesa e parë për vlerësimin e sistemeve me rëndësi strategjike për pozitat përkatëse, me date 16.10.2023 është paraqitur kërkesa e dyte për rishqyrtim pas mos përfshirjes ne raportin paraprak, dhe së fundi me datë 11.01.2025 është paraqitur kërkesa e trete për shqyrtimin e sistemeve dhe pozitive përkatëse, për të cilat ankuesit në ankesë e potencojnë se nuk kanë pranuar asnjëherë përgjigje nga institucioni përkatës asnjë përgjigje çoftë pozitive apo negative si dhe organi i punësimit përmes përgjigjes se datës 19.03.2026 nuk ka arrit te na dëshmoj se kane marre ndonjë përgjigje lidhur me kërkesat e ankuesve, të cilët kanë sqaruar se nuk kemi njohuri rreth vlerësimit të këtij komisioni pasi që ky komision është themeluar nga Qeveria.

Tutje përmes vendimit me Nr.08/280 të datës 19.12.2025 është aprovuar raporti i tretë i punës se Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rendësi Strategjike, në të cilin raport nga ZKA janë përfshire këto sisteme, Qendra e të dhënave, e-Cabinet, si dhe Sistemi elektronik -Portali Shtetëror i Gazetës Zyrtare, i cili sistem i ka përfshirë gjashtë (6) pozita në ZKA, Udhëheqësin e divizionit për Teknologji Informative në kategorinë B3, Specialistet mbështetës për TI ne kategorinë B7, Administratoret e rrjetit ne kategorinë B6 , Administratoret e sistemit ne kategorinë B6, Administratorin e bazës së të dhënave në kategorinë B6 , si dhe Zyrtarin e Lartë për Web faqen (sistemin elektronik) të Gazetës Zyrtare në kategorinë B6, pozita të cilat sipas aktit të emërimit mbajnë parashtruesit e ankesës.

Ankues A. G përmes emalit të datës 26.02.2026 i është drejtuar Zyrës së Personelit në ZKM duke kërkuar që të shqyrtohet llogaritja dhe kompensimi i diferencës së pagës për gjashtë (6) zyrtaret e përfshirë në raportin e tretë të punës së Komisionit të Vlerësimit të Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rendësi Strategjike, duke sqaruar se vonesa në përfshirjen në këtë raport nuk duhet të prodhoj pasoja financiare në dëme të zyrtareve të përfshire. Ndërsa kjo e fundit kishte kërkuar opinion ligjor nga Departamenti Ligjor i Ministrisë se Digjitalizimit dhe Administratës Publike lidhur me kërkesën e ankuesve ku Udhëheqësja e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit në këtë ministri A.B i është përgjigjur citoj: *Vendimi i Qeverise prodhon efekte juridike nga momenti i hyrjes në fuqi, përkatësisht pas publikimit në gazetën Zyrtare të Republikës se Kosovës, përveç nëse në vete vendimin përcaktohet ndryshe. Në mungesë të një diapozitivi që parashikon zbatim retroaktiv, ai zbatohet vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi.* Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në ZKM në po të njëjtën datë ka njoftuar ankuesit lidhur me përgjigjen e lartcekur.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se kompensimi i pagës sipas kësaj kategoria bëhet në mënyrë retroaktive nga muaji shkuar 2023

kur ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, duke kërkuar kompensimin për periudhën shkurt 2023 deri në hyrjen në fuqi të vendimit NR.08/280.

Ne kuptim të themelësisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit NR.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023 përkatësisht nenit 2 paragrafi 1: “ 1 Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit,... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj ” dhe nenit 14, paragrafi 3:3 Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht duke ju referuar këtij përcaktimi ligjor , Kolegji i Këshillit konstaton se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar në shërbim civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbim Civil.

Andaj duke ju referuar kuadrit ligjor si me lartë dhe meqenëse pozita e ankuesve nga organi përgjegjës dhe kompetent është përfshirë në listën e ekspertëve lidhur me Sistemin Shtetëror të Informacionit dhe Komunikimet me Rëndësi Strategjike, atëherë, në vlerësimin e Kolegjit, e drejta e kompensimit për pozita të njohura të ekspertëve sipas Rregullores (QRK) NR.22/2024, rrjedh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, ndërsa pretendimi i ankuesve për kompensimin e diferencës së pagës si ekspert nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit NR.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik e deri në zbatimin e vendimit të Qeverisë Nr. 08/280 të datës 19.12.2025, nuk qëndron pasi që sistemi në të cilin bëjnë pjesë pozitat e ankuesve, nuk ka qenë i përfshirë në Raportin e parë e as në të dytin, të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimi me Rëndësi Strategjike.

Theksuar si me lartë, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, vendosi ta aprovoj pjesërisht ankesën e datës 24.02.2026 si të bazuar duke e refuzuar pretendimin e ankuesve që kompensimin e pagës në mënyre retroaktive të bëhet nga hyrja në fuqi të Ligjit NR.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa detyroj Sekretarin e Përgjithshëm, në Zyrën e Kryeministrit, që të bëjë kompensimin e diferencës së pagës për ankuesit nga dita e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.22/2024 të datës 27.08.2024, për Ekspert, bazuar në koeficientin e përcaktuar sipas raportit të Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike dhe të miratuar me vendimin me numër NR.08/280 të datës 19.12.2025 të Qeverisë së Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA, A.nr.276/2026

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të ankuesve A.G;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në ZKM dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK -së.*